




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRAČANICA

Në bazë të nenit 52 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 11 të Udhëzimit administrativ nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, nenit 25 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa thërret mbledhjen e jashtëzakonshme dhe dërgon:

FTESË

I/e nderuar,

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e katërt të jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet të martën më datën 29.09.2026. Mbledhja do të fillojë në orën 10:30. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit, kati i parë nr.2.11 në objektin e Komunës së Graçanicës në Graçanicë.

Të bashkëngjitur me ftesë gjeni rendin e ditës dhe materialin për këtë mbledhje. Për këtë mbledhje është caktuar ky:

REND I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt të rregullt, e mbajtur më datën 26.08.2026.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-buxhetit të Komunës së Graçanicës për periudhën 2027-2029, me propozimin e drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Sllavisha Niçiq (*Slaviša Ničić*).
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për shpalljen e parcelës nr.1438-0 ZK Graçanicë me interes publik me qëllim të këmbimit me pronën e paluajtshme të komunës, me propozimin e kryetarit të Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq (*Novak Živić*).
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për themelimin e Komisionit të Kuvendit për zgjedhjen e Këshillave lokale, me propozimin e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq (*Milan Dimitrijević*).
5. Informata për fillimin e vitit shkollor, me propozimin e drejtoreshës së Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë, Brankica Niçiq (*Brankica Ničić*).
6. Të ndryshme.

Me respekt,

Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa

Milan Dimitrijević

